

Në bazë të vendimit *Nr.14-315/1* të datës 10.04.2020 të Këshillit mësimor Shkencor të Fakultetit Ekonomik, për formimin e Komisionit për vlerësimin e disertacionit të doktoraturës, si dhe në bazë të nenit 57 të Rregullores për kriteret bazë për organizimin e studimeve pasdiplomike dhe studimeve të doktoraturës të Universitetit Shtetëror të Tetovës, komisioni në përbërje: **1. Prof.Dr.Seadin Xhaferi**, **2. Prof.Dr.Alifetah Selimi**, **3. Prof.Dr.Etem Iseni**, **4. Prof.Dr.Petrit Polozhani**, **5. Prof.Dr.Ibish Mazreku**, pasi vlerësoi disertacionin e doktoraturës me titull:“ *Sfidat me të cilat duhet të ballafaqohet Banka popullore e republikës së Maqedonisë për integrim në sistemin monetarë evropian dhe eurozonë*”, të kandidatit **Mr.sc. Gazmend Dehari**, paraqet këtë:

RECENSION

për vlerësim të disertacionit të doktoraturës „*Sfidat me të cilat duhet të ballafaqohet Banka popullore e Republikës së Maqedonisë për integrim në sistemin monetarë evropian dhe eurozonë*“ të kandidatit Gazmend Dehari

Këshilli mësimor shkencorë i fakultetit ekonomik pranë Universitetit të Tetovës, në mbledhjen e saj të rregullt, na përcaktoi si anëtarë të komisionit për vlerësim tëpunimit të doktoraturës të kandidatit Gazmend Dehari me temë : „*Sfidat me të cilat duhet të ballafaqohet Banka popullore e republikës së Maqedonisë për integrim në sistemin monetarë evropian dhe eurozonë*“.

Punimi u shqyrtua me vëmendje të thellë, me qëllim që përpara këshillit mësimor shkencorë të fakultetit të dorëzojmë këtë

RAPORT

Punimi i doktoraturës nga kandidati Gazmend Dehari me temë : „*Sfidat me të cilat duhet të ballafaqohet Banka popullore e republikës së Maqedonisë për integrim në sistemin monetarë evropian dhe eurozonë*“ përmban 250 faqetekst dhe 12 faqe referenca nga burimet e përdorura gjatë përpunimit të tezave të prezantuara në kornizat e tetë kapitujve:

1. Kushtet për aderim në Euro - zonë;
2. Rreziku dhe kostoja e anëtarësimit në Euro zonë;
3. Sinkronizimi i ciklit të biznesit;
4. Përparësitë e anëtarësimit në euro zonë;

5. Shpjegimi i integritimit monetarë sipas teorisë së zonës optimale monetare;
6. Tregu i punës si mekanizëm përshtatshmërie;
7. Diversifikimi i prodhimit – eksportit;
8. Investimet e huaja direkte.

Në kornizat e **kapitullit të parë** të punimit të doktoraturës kandidati Gazmend Dehari bën një përshkrim të kushteve që duhet plotësuar që një shtet i caktuar të bëhet pjesë e zonës euro. Në pjesën e parë prezantohen hapat e para, të cilat ndahen në tre faza, të ndërmara nga shtetet europiane për të krijuar një union ekonomik dhe monetarë të qëndrueshëm. Faza e parë rezulton me krijimin e monedhës së parë europiane, paraardhës të euros, të quajtur ECU (European Currency Unit). Gjatë fazës së dytë u bë një intensifikim i politikave të vendeve anëtare dhe u krijua instituti monetarë europian, i cili njëkohësisht konsiderohet si paraardhës i Bankës qendrore europiane. Ndërsa në fazën e tretë potencohet se është krijuar mekanizmi i kurseve të këmbimit II, për tu mundësuar vendeve anëtare të zbatojnë një politikë monetare të përbashkët. Në pjesën e dytë përshkruhet vendosja e themeleve për krijimin e euro zonës sipas traktatit të Maastrich-it ku u vendosën kriteret e konvergjencës, duke i ndarë ato në dy grupe, kriteret fiskale dhe monetare.

Tek **kapitulli i dytë** i punimit të doktoraturës kandidati Gazmend Dehari hapin e anëtarësimit të një shteti në një union monetarë dhe ekonomikë, siç është ai i euro zonës, e cilëson si një proces të rëndësishëm, ku gjatë gjithë etapave të këtij procesi vendi kandidat do të duhet që të realizoj një analizë empirike të theksuar për të vlerësuar rrezikun dhe koston me të cilën duhet të përballlet. Kandidati potencon se braktisja e një politike monetare autonome do të përfaqëonte një rrezik tejet të madh për një vend kandidat në kushtet kur ekonomia vendore do të kishte të vështirë që të përshtatet ekonomive të cilat veç më janë anëtare të zonës monetare. Në këtë pjesë janë të cekura faktorët e ndryshëm të cilët mund të ndikojnë në rritjen e kostove të cilat mund të shfaqen nga humbja e pavarësisë për përcaktimin e normave të interesit për një shtet si R. e Maqedonisë. Meqë, politika monetare do të udhëheqjet nga banka qendrore evropiane, banka qendrore e Maqedonisë nuk do të ketë në dispozicion këtë mekanizëm për të mbrojtur ekonominë vendase nga krizat eventuale të cilat mund të shfaqen. Duke patur parasyshë se ekonomia e Maqedonisë karakterizohet si e vogël, nga shkak i të pasurit të një niveli të ulët të GDP-së, është e ekspozuar më së shumti ndaj rreziqeve që rezultojnë nga globalizimi i tregjeve,

prandaj edhe një anëtarësim në një zonë monetare për ekonomitë e vogla do të përbënte një mbrojtje nga sulmet spekulative të cilat rezultojnë nga lëvizja e lirë e kapitalit. Më pas kandidati duke përdorur literaturën e përshtatshme thekson studimet e ndryshme të realizuara nga autorë relevant të cilët i kanë kushtuar një rëndësi të veçantë sinkronizimit të ciklit të biznesit dhe rritje së mirëqenies, të vendeve anëtare si një kusht për integrim në një zonë monetare. Si autorë më relevant në këto fusha nga kandidati citohen Lucas (1987), Imrohroglu (1989), Atkeson dhe Phelan (1995), Gali, Gertler dhe Lopez (2002), Melitz dhe Zumer (2000).

Në **kapitullin e tretë** kandidati sqaron konceptin e sinkronizimit të ciklit të biznesit si një faktor i rëndësishëm, tek i cili duhet të bazohet vendimi se a do të jetë i përshtatshëm anëtarësimi i një shteti të caktuar në një union monetarë. Me qëllim që të paraqitet një koncept sa më i qartë, si fillim, janë cekur studimet e ndryshme të cilët kanë dëshmuar rëndësinë që ka sinkronizimi i ciklit të biznesit, kurse më pas për ti parashtruar definimet më të rëndësishme, janë paraqitur aspektet më thelbësore të sinkronizimit të cikleve. Kandidati Gazmend Dehari, i veçon si relevante studimet e Jean Imbs (2003), Krugman (1992), Canova and Dellas (1993), Baxter dhe Kouparitsas (2004), Clark dhe van Wincoop (1999), Markus Baltzer, Lorenzo Cappiello, Roberto A. De Santis, dhe Simone Manganelli (2008), Frankel dhe Rose (1998). Autorët e lartpërmendur duke analizuar një numër të madh të shteteve të zhvilluara, vërejtën një efek pozitiv të rritjes së tregëtisë bilaterale mbi sinkronizimin e cikleve të biznesit. Sipas studimeve të cekura, intensifikimi i tregëtisë bilaterale do të ketë ndikim pozitiv në sinkronizimin e ciklit të bizneseve nëpërmjet rritjes së tregëtisë në mes shteteve në krahasim me shkallën e tyre të specializimit, gjegjësisht tregëtinë e specializuar. Më tutje, testohen dhe vlerësohen ndikimet e indikatorëve struktural dhe politik të cilët janë të rëndësishëm për euro zonën si dhe për shtetet të cilat synojnë të jenë pjesë e saj. Në vazhdimësi të analizës bëhet matja e ciklit të biznesit në mes shteteve të euro zonës dhe atij të R. së Maqedonisë, ku llogaritet koeficienti i korelacionit në mes pjesës ciklike të GDP-së të Maqedonisë me atë të shteteve anëtare të euro zonës. Kandidati bazohet tek Baxter dhe Kouparitsas (2004) dhe Imbs (2004), për ti definuar determinantët, të cilët i ndanë në dy grupe tradicional dhe bashkëkohorë, që ndikojnë mbi definimin e ciklevetë biznesit. Si determinantë tradicional theksohen tregëtia bilaterale, hapja e një shteti ndaj tregëtisë, shkalla e specializimit të tregëtisë dhe specializimi ekonomik. Ndërsa si indikatorë bashkëkohorë potencohen, diferencialet e normave të interesit afatshkurt, luhatshmëria e kursit të këmbimit nominal, diferencialet e deficitit fiskal, kompetitiviteti dhe tregu financiarë. Gjithmonë duke u

bazuar në analizën e kandidatit, përcaktohet komponenta ciklike e bazuar në të ashtuquajturin filterin BP të prezantuar nga Baxter dhe King në (1999). Sipas të dhënave të prezantuara, vërehet qartë se R. e Maqedonisë ka një cikël të biznesit të sinkronizuar me ato të shteteve të euro zonës, unionit europian si dhe shteteve fqinje. Në analizë definohet edhe se sa ky korrelacion është i fuqishëm dhe se cilat janë ato determinanta të cilat ndikojnë në këtë sinkronizim. Kandidati për të parë se sa ndikim kanë determinantët të cilat përcaktojnë sinkronizimin e ciklit të biznesit ka realizuar analizën e kufijëve ekstrem të bazuar tek Leamer (1983). Si pjesë të studimit mbi ciklet e biznesit një vëmendje të veçantë u kushtohet edhe mekanizmave të tjerë të cilët ndikojnë në sinkronizimin, siç janë ndikimi i kursit të këmbimit, mekanizmi i përshtatshmërisë së tregut të punës dhe ai i përshtatshmërisë fiskale, tek i cili kandidati, duke përdorur formën e regresionit linear OLS, për të parë efektshmërinë e politikës fiskale vlerëson rëndësinë e stabilizatorëve automatik të ekonomisë, dhe relacionin në mes madhësisë së qeverisë dhe luhatshmërive të tjera të cilët shërbejnë për matjen e aktivitetit ekonomik.

Kapitulli i katërt është i kushtuar disa tezave kryesore të punimit të kandidatit Gazmend Dehari në të cilin përdoren lloje të ndryshme të modeleve për ti dëshmuar po të njëjtat dhe njëkohësisht janë të cekura këndvështrimet moderne në lidhje me përparësitë që u ofrohen shteteve të cilat janë anëtare të një unioni monetarë siç është ai i euro zonës. Kandidati për të vlerësuar se nëse për ekonominë e R. së Maqedonisë do të ishte pozitiv anëtarësimi i saj në një union ekonomik dhe monetarë, siç është ai i euro zonës, analizon në mënyrë objektive përfitimet potenciale, afatshkurta dhe afatgjata, të cilat mund të nxirën nga ky integrim. Efektet e pritura afatshkurta që do të rezultojnë nga anëtarësimi në unionin monetarë të euro zonës sipas kandidatit nënkuptojnë zvogëlim të kostove të transaksionit si rezultat i eliminimit të kursit të këmbimit të monedhës vendore me euron, ku jepet edhe një vlerësim se sa do të jetë kursimi i ekonomisë vendore nga ky eliminim. Si pjesë e përfitimeve nga kandidati ceken edhe ulja e normave të interesit afatgjatë, ku paraqet një pasqyrë të normave të interesit për shumicën e shteteve të cilët janë anëtarësuar në zonën euro dhe në të cilat rezulton që të ketë patur një rrënie të normave të interesit afatgjatë. Për sa u përket përfitimeve afatgjata, bëhet një vlerësim i monedhës së përbashkët mbi efektin e saj pozitiv mbi investimet, si një faktor i cili ka një ndikim të konsiderueshëm në zhvillimin ekonomik të një vendi. Në këtë pjesë të studimit potencohet

seinkuadrimi i Maqedonisë në suazat e zonës euro do të ndikonte që të ketë një rritje të investimeve qoftë në sektorin privat apo në atë publik. Duke përmendur studimet relevante të cilat trajtojnë ndikimin e investimeve të huaj dhe të produktivitetit të Pavlos Petroulas (2006), Arturo Bris, Yrjö Koskinen dhe Mattias Nilsson (2006), Bartram dhe Karolyi (2003), David Sondermann (2012), Byrne dhe Davis (2003), Aizenman dhe Marion (2001) paraqiten aspektet pozitive të integritimeve në një zonë monetare. Në kornizat e kësaj pjese janë të analizuar edhe përfitimet që një ekonomi e caktuar mund ti nxjerr nga një anëtarësim në një union ekonomik dhe monetarë të cilat kanë të bëjnë në një pjesë të madhe me ndikimin e monedhës së përbashkët mbi tregtinë. Këndvështrimet në lidhje me tregtinë dhe ndikimet e saja kandidati i bazon tek Rose (2000), Micco, Ordoñez and Stein (2003) dhe Frankel (2008) të cilët duke përdorur lloje të ndryshme të metodologjive dhe duke ndryshuar vazhdimisht mostrën dhe modelet e përdorura, erdhën në përfundim se efekti i përmirësimit të tregtisë si rezultat i euro-s është signifikativ. Gjithashtu, në këtë pjesë potencohet se sinkronizimi i ciklit të biznesit të R. së Maqedonisë me ekonominë e kontinentit europian e bëjë atë më të afërt me zonën monetare europiane. Sa pozitivë do të jetë ky efekt definitivisht, mund të shihet vetëm pas anëtarësimit. Megjithatë, duke përdorur metodologji të caktuara është dhënë një estimacion i përafërt. Kandidati duke u bazuar në studimin e Rose (2000), ka sjatur disa modele të regresionit me ndihmën e të cilëve bën vlerësimin e efektit e anëtarësimit mbi tregtinë, duke përdorur nivelet e eksportit.

Kapitulli i pestë është kushtuar përpjekjeve të realizuara nga teoria e zonës optimale monetare për të shpjeguar proceset e rëndësishme të krijimit të një zone monetare optimale. Kandidati thekson se teoria optimale e zonave monetare është mënyra më e pranuar nga studimet bashkëkohore për të vlerësuar kostot dhe përfitimet e një shteti, që dëshiron të pranojë monedhën e përbashkët. Në suaza të kësaj teorie potencohet se kushtet do të ishin optimale që një vend do të anëtarësohet në një zonë monetare siç është ajo e euro zonës, me përmirësimin e disa indikatorëve makroekonomik, të cilët do të mundësojnë realizimin e një bilanci të jashtëm, që nënkupton stabilizimin e zërave në bilancin e pagesës në një nivel të qëndrueshëm, me qëllim për mbrojtjen e ekonomisë vendore nga pasojat e padëshiruara si rezultat i ndonjë krize të mundshme ekonomike dhe financiare dhe balancin e brendshëm që nënkupton arritjen e një pike optimale stabile në mes inflacionit dhe nivelit të papunësisë. Kandidati duke cekur fillësën e teorisë optimale monetare, parashtron mekanizmat më të rëndësishëm që luajnë rol në përshtatshmërinë e ekonomisë në mungesë të një përshtatshmërie nëpërmjet kurseve të këmbimit. Si të tilla në

studimin theksohet, fleksibiliteti i pagave dhe çmimeve, lëvizja e lirë e faktorëve të prodhimit, kapitalit dhe punës, integrimi i tregjeve financiare, shkalla e hapjes së ekonomisë, diversifikimi i prodhimit dhe konsumit, ngjashmëritë në normat e inflacionit, integrimi fiskal dhe integrimin politik. Kandidati Gazmend Dehari thekson edhe autorët të cilët kanë dhënë kontributin e tyre shumë të rëndësishëm në këtë fushë si, Mundel (1961), McKinnon (1963) dhe (Corden 1972) të cilët konsiderohen si themelues të kësaj teorie dhe përkrahës të një këndvështrimi tradicionalist. Gjithashtu, nuk mungojnë edhe aspektet më bashkëkohore të teorisë optimale, të cilat janë mbështetur nga Alesina, Barro dhe Tenreyeto (2002), Calvo dhe Reinhart (2002), Melitz (1991), De Grawe (2002), Frankel dhe Rose (1997), Krugman (1993) dhe Bayoumi dhe Eichengreen (1992) të cilët kanë studiuar rolin e unionit monetarë mbi uljen e kostove të transaksionit për të zhvilluar tregtinë, specializimin në prodhimin e atyre mallrave për të cilat vendet kanë një avantazh komparativ dhe nivelin e integritimeve të ekonomive të ndryshme. Përveç aspekteve të përmendura paraprakisht, kandidati, veçon punimin e Frankel (1999), i cili propozoi disa kriteret plotësues që duhet të merren parasysh për të vlerësuar avantazhet e një anëtarësimi në një union monetarë dhe ekonomik. Si kriter shtesë ai përmendi inflacionin e importuar, mungesën e kredibilitetit të institucioneve politike të vendit dhe aksesin në një sistem financiarë të rregulluar mirë dhe me kredibilitet.

Në **kapitullin e gjashtë** të punimit të doktoraturës kandidati përfshinë tregun e punës si një mekanizëm përshtatshmërie ndaj një mungese të një politike monetare të brendshme. Duke u bazuar në këndvështrimin e Mundell (1961), potencohet se të dy nivelet, ai i pagave dhe ai i mobilitetit të forcës punëtore duhet të kombinohen në një mënyrë që të sigurojnë një nivel të ulët të papunësisë dhe të normës së inflacionit në vendet anëtare të një zone monetare të integruar. Me balancimin e këtyre dy faktorëve shtetet anëtare do të jenë më të përgatitura që të përballen me pasojat negative mbi ekonominë e tyre respektive. Më pas kandidati në seksionet në vazhdim, analizon mënyrat se si një shtet i caktuar mund të bëjë tregun e punës më fleksibil, me qëllim që të realizojë një integrim të suksesshëm në një zonë monetare, dhe këtu i kushtohet një fokus të veçantë tregut të punës së Republikës së Maqedonisë. Të bazuar në literaturën përkatëse, theksohen disa mënyra nëpërmjet të cilave mund të rritet fleksibiliteti i tregut të punës, të cilat janë rritja e punës me kohë të caktuar, puna e përkohshme, vetë punësimi dhe rritja e marrëveshjeve kolektive bashkëkohore. Në vazhdim kandidati fokusohet në fleksibilitetin e tregut të punës së R. së Maqedonisë, duke potencuar se nëse R. e Maqedonisë paraqet interesim për tu

bërë pjesë e një unioni ekonomik dhe monetarë si ai i euro zonës, atëherë nuk do të ketë mundësinë që të përshtat ekonominë e vendit me ndihmën e kursit të këmbimit për tu ballafaquar me pasojat ekonomike negative. Njëri prej mekanizmave që do të ketë në dispozicion R. e Maqedonisë pasi që të jetë pjesë e një unioni ekonomik dhe monetarë, do të ketë pikërisht tregun e punës si mekanizëm përshtatshmërie. Më pas realizohet një krahasim i nivelit të papunësisë mes R. së Maqedonisë, Euro zonës dhe Unionit europian ku kandidati thekson rolin e rëndësishëm që kanë institucionet qeveritare në tërë këtë proces. Nuk mungon gjithashtu edhe literatura e pasur e përdorur nga kandidati për të arsyetuar tregun e punës si një mekanizëm përshtatshmërie. Si studime relevante ceket ai i Grubb dhe Wells (1993), të cilët duke krahasuar matjet e ndryshme statistikore, shpjeguan se si rregullativat e ndryshme të tregut të punës dhe format e punës janë të lidhura në mes veti në shtetet e Unionit Europian. Gjatë analizës së ndikimit të taksave, Belot dhe Ours (2000) erdhën në përfundim se, për një numër të madh të shteteve të analizuara të OECD –së, stimujt financiar, gjegjësisht niveli i taksave, ishte indikator kryesorë për të vendosur drejtimin të cilin do të marrë niveli i papunësisë. Studim tjetër i cekur nga kandidati është ai i Baker, Glyn, Howell dhe Schmitt (2002), të cilët duke vërejtur divergjencën në nivelet e papunësisë në shtetet të cilat ishin pjesë e OECD-së, theksuan se po të njëjtat mund të shpjegohen nga qasja e institucioneve vendore, të cilat çojnë drejt një jo fleksibiliteti të tregut të punës dhe si faktorë kryesorë për këtë përmenden, beneficionet e mira të papunësisë, mbrojtjen në punësim dhe organizata sindikale të fuqishme. Për definim të fleksibilitetit të tregut të punës kandidati përdorën këndvështrimin e Pissarides (1997), i cili fleksibilitetin e tregut të punës e definoi si shpejtësi përmes së cilës një ekonomi e caktuar do të mund që të përshtatet ndaj një krize ekonomike. Duke u bazuar në po këtë studim kandidati paraqet disa mekanizma të cilat shërbejnë për të identifikuar nivelin e fleksibilitetit të tregut të punës edhe atë fleksibiliteti i pagës relative, fleksibiliteti i pagës reale, fleksibiliteti i pagës nominale, lëvizshmëria gjeografike e punës, fleksibiliteti i punësimit dhe fleksibiliteti funksional,

Në **kapitullin e shtatë** kandidati shtjellon diversifikimin e prodhimit, gjegjësisht, eksportit, si një kriter të rëndësishëm për të kompletuar analizën e vendit për tu bërë pjesë e një unioni monetarë dhe ekonomik. Në kornizat e këtij kapitulli analizohet diversifikimi i prodhimit nga këndvështrimi i llojllojshmërisë së produkteve të cilat janë të destinuara për tregun e jashtëm dhe të cilat do të mundësojnë një shteti që të zvogëloj rrezikun dhe pasojat mbi ekonominë vendore në kohë krize. Si fillim kandidati Gazmend Dehari definoi strukturën e diversifikimit të

eksporteve, të cilat mund të jenë të dy formave, diversifikimi vertikal dhe ai horizontal. Kurse më pas cekën studimet më bashkohore të cilat kanë të bëjnë me ndikimin e diversifikimit mbi tregëtinë. Si studiues të mirë të diversifikimit të eksporteve theksohet Paul Krugman (1980), i cili duke tentuar të përpilonte një model të ri të shpjegimit të tregëtisë ndërkombëtare u mundua që të prezantojë një kornizë të re teorike duke inkorporuar diferencimin e produkteve si një element të rëndësishëm që do të ndikojë në zhvillimin e tregëtisë. Modeli i propozuar nga Krugman kishte parasyshtë ekonomitë e shkallës në procesin e prodhimit dhe se ndërmarrjet mund që të diferenciojnë produktet e tyre pa ndonjë kosto. Më pas si një studim me ndikim ceket Hummels dhe Klenow (2005) të cilët shpjeguan se si shtetet e fuqishme, të cilat janë të afta që të eksportojnë sasi të larta të një produkti të caktuar, janë të prirura që të eksportojnë më së shumti se ekonomitë e vogëla. Megjithatë, kandidati thekson edhe disa studime tjera të cilat janë të rëndësishme në këtë fushë si Imbs dhe Wacziarg (2002), Cadot, Carrère, Kuenova dhe Strauss-Kahn (2009), Pacheco dhe Pierola (2008) të cilat kanë definuar format e ndryshme me ndihmën e të cilave mund të bëhet matja e nivelit të diversifikimit të prodhimit. Më pas, kandidati duke përdorur mënyrën e matjes së diversifikimit të paraqitur tek Hummels dhe Klenow (2002), përcakton nivelin diversifikimit të eksporteve të R. së Maqedonisë me Zonën Euro, Unionin Europian dhe botën e jashtme. Sipas analizës së kandidatit ekziston një rritje të diversifikimit të eksporteve dhe të importeve të Maqedonisë, në kategoritë e reja të produkteve, drejt regjionit me të cilin ajo kryesisht e realizon tregëtinë. Më tutje, kandidati përpilon një analizë tjetër në lidhje me diversifikimin duke përdorur indeksin e Herfindahl-Hirschman (HHI) i cili duke marrë parasyshtë rëndësinë e produktit potencon se sa janë të koncentruara eksportet dhe importet e një shteti të caktuar. Nëpërmjet kësaj analize definohet se cilat janë determinantët të cilat ndikojnë në diversifikimin e eksporteve, ku si më të rëndësishmit theksohen tregëtia si përqindje e prodhimit të brendshëm bruto, eksporti i mallrave dhe shërbimeve si përqindje e prodhimit të brendshëm bruto dhe prodhimtaria e eksportit të mallrave.

Kapitulli i tetë i kushtohet faktorit të investimeve të huaja direkte si një përcaktues i rëndësishëm në vendimin e një shteti për tu bërë anëtarë i një unioni ekonomik dhe monetarë. Në këtë kapitull kandidati trajton korelacionin në mes monedhës së përbashkët euros dhe fluksit të investimeve të huaja, si dhe vërteton mënyrat si anëtarësimi në unionin monetarë dhe monedha e përbashkët do të përforcojë nivelin e investimeve ekzistuese dhe do të ndikojë pozitivisht në prurjen e investimeve të reja. Në pikënisje të analizës kandidati, duke u bazuar në literaturën e

përgjithshme, bën ndarjen e investimeve në dy lloje, edhe atë, në horizontale, të cilat kanë të bëjnë me situatat kur ndërmarja e cila e bën investimin e huaj direkt e prodhon të njëjtin produkt në një fabrikë në shtetin amë apo tregun amë dhe në një fabrikë e cila operon në një treg të huaja dhe investimet vertikale të realizuara nga ndërmarjet të cilat në tregun vendorë dhe të jashtëm prodhojnë produkte të ndryshme. Gjithashtu, kandidati përdorën literaturë bashkohore tek të cilat i bazon këndvështrimet e veta në lidhje me investimet e huaja si faktorë relevant në stimulimin e zhvillimit ekonomik, ndër të cilat ai thekson Adam (2013), Flam dhe Nordström (2007), Petroulas (2007), Schiavo (2007), Brouwer et al. (2008), De Sousa dhe Lochard (2009 dhe 2011), DingadheDingová (2011), Folfas (2012), Pantelidisdhe al. (2012), AristotelousdheFountas (2012), Aristotelous(2005) dhe Wei dhe Choi (2002). Nga studimet e përdorura nga kandidati potencohet se monedha e përbashkët ka mundësi që të ndikojë në nivelin e investimeve të huaj me ndihmën e tre kanaleve : eliminimi i pasigurisë për sa i përketë luhatshmërisë së kursit të këmbimeve, ulja apo eliminimi i kostove të transaksionit dhe rritja e transparencës së çmimeve. Me përdorimin e të dhënave statistikore në vazhdim, kandidati duke zbatuar modelin ekonometrik të Aristotelous dhe Fountas (2012), analizon me ndihmën e metodave të ndryshme, determinantët që ndikojnë në nivelin e investimeve të huaja direkte dhe rrolin që mund të ketë anëtarësimi në një union monetarë, duke patur si fokus zonën euro. Kandidati përveç analizës së determinantëve të investimeve të huaja, realizon edhe një analizë krahasuese të investimeve të tërhequra në mes anëtarëve të euro zonës, anëtarëve të unionit europain dhe atyre shteteve të cilat nuk janë anëtarë në asnjë lloj niveli të integritit. Gjithashtu, kandidati duke vështruar nivelin e investimeve të huaja direkte në Maqedoni të realizuar nga ndërmarrje të ndryshme të cilat kanë patur si vend origjine njërin nga shtetet anëtare të euro zonës dhe për të bërë një përshtatje të studimit të efektit të monedhës së përbashkët mbi investimet e huaja direkte nga zona euro në R. e Maqedonisë prezanton një analizë të regresionit dhe përcakton determinant që ndikojnë më së shumti në këtë fluks të investimesh.

VLERËSIM I PËRGJITHSHËM I PUNIMIT TË DOKTORATURËS ME PROPOZIM

Komisioni për vlerësim të punimit të doktoraturës „*Sfidat me të cilat duhet të ballafaqohet Banka popullore e republikës së Maqedonisë për integrim në sistemin monetarë evropian dhe eurozonë*“ nga kandidati Gazmend Dehari, në këtë pjesë i ndanë kontributet profesionale dhe shkencore

kualitative të punimit në fushën e anëtarësimit dhe të integritimeve në zonat monetare dhe ekonomike.

- I. Integritet e ekonomive paraqesin një fushë të re për studiuesit e ndryshëm akademik. Në dekadën e fundit interesi për këtë problematikë është rritur konsiderueshëm dhe njëkohësisht nuk mungojnë edhe kërkimet shkencore në këtë lëmi. Integritet ekonomike veç më janë të konsideruara si diciplina të veçanta në univerzitetet me repute botërore. Fakulteti ekonomik pranë Universitetit të Tetovës mburret që është ndër të parat institucione të arsimit të lartë, në rajon, ku janë realizuar kërkime shkencore në këtë fushë studimi. Mozaikun e punimeve shkencore në fushën rëndësishme të problematikave të integritimeve ekonomike e plotëson pikërisht punimi i kandidatit Gazmend Dehari, i cili bartë titullin : „*Sfidat me të cilat duhet të ballafaqohet Banka popullore e republikës së Maqedonisë për integritim në sistemin monetarë evropian dhe eurozonë* “. Kandidati vendosi që të realizojë një punim, i cili trajtohet për herë të parë tek, për të cilin ekziston një literaturë tepër modeste.
- II. Kandidati gjatë përpunimit të temës së trajtuar përdorën një plejadë të tërë të burimeve relevante shkencore, nga të cilat, nëpërmjet analizës sintetike dhe qasjen komparative krijon një përmbledhje koncize të qëndrimeve teorike për këtë problematikë. Gjithashtu, në të njëjtën kohë nga kandidati bëhen kërkime shkencore duke zbatuar modele dhe metodologji të ndryshme studimi, ndërsa rezultatet e fituara i implementon në kornizat e temave të trajtuara në këtë punim.
- III. Fundamentet e përpunimit të punimit të doktoraturës kandidati i vendos nëpërmjet prezantimit të definimeve më relevante të lidhura me konceptin e integritimeve në zona monetare optimale, në të cilën analizon kushtet që duhet plotësuar për tu anëtarësuar, modelet më të përshtatshme të vlerësimit, ndikim që ato kanë në ekonominë, aftësinë e një ekonomie vendore për tu përballuar me krizat ekonomike dhe financiare etj. duke bërë në të njëjtën kohë edhe sintezë të përshtatshme. Prezantimi i gjerë i modeleve dhe karakteristikave të ndryshme të vlerësimit të anëtarësimit në një zonë monetare ofron një pasqyrë të qartë se si këto zona funksionojnë dhe veprojnë në botën e gjërë, ndërsa mbështetja e tyre në shembuj adekuat e pasuron lëndën e studimit të realizuar. Vlen të theksohet se për R. e Maqedonisë nuk ekzistojnë studime

të përshtatshme të cilat potencojnë efektin që do të ketë një integrim i mundshëm në një zonë monetare si ajo e euro zonës, për këtë arsye kandidati paraqet simulime të ndryshme të realizuara nëpërmjet modeleve të sajara të cilat mund të shërbejnë si një bazë ideshë për themelimin e vlerësimeve të përshtatshme. Përmes një qasje gjithëpërfshirëse analitike të modeleve që shërbejnë për të vlerësuar faktorët që ndikojnë në marrjen e vendimit për të qenë pjesë e një unioni monetarë si ai i euro zonës, kandidati vjen në përfundimin se nuk ekzistonë një model i vetëm vlerësimi i cili do të jetë i pranueshëm në të gjitha rrethanat, por bëhet fjalë për forma të ndryshme hibride të cilat janë në varësi direkte nga faktorë të ndryshëm. Në punim është dhënë një pëmbledhje koncize e determinantëve të cilët më së shpeshti ndikojnë në një anëtarësim të sukseshëm në një zonë monetare, si dhe fushat të cilat duhet përmirësuar Maqedonia për të qenë në hap me ekonomitë e anëtarëve që cilësohen si më të sukseshëm në unionin monetarë të euro zonës. Komisioni e pranon qëndrimin e kandidatit se përshtatja e determinantëve të cilët do të mundësojnë që ekonomia vendore të krijojë vlera sociale, mirëqënie dhe begati do të ndikojë pozitivisht në zvogëlimin e problemeve, të natyrave të ndryshme, të cilat janë produkt i një tranzicioni të dështuar të Maqedonisë.

- IV. Përmes përpunimit substancial të tezës së doktoraturës, kandidati dallon karakteristikat të cilat mundësojnë një integrim monetarë të sukseshëm. Modelet e ndryshme të përdorura shërbejnë për të dhënë një pasqyrë të përgjithshme të përfitimeve si rezultat i anëtarësimit të Maqedonisë në një unionin monetarë. Gjatë fazave të anëtarësimit bëhet një analizë e datajuar e përfitimeve nga vendet kandidate të cilat kryesisht kanë të bëjnë me uljen e kostove të transaksionit, eliminimin e rrezikut të kurseve të këmbimit dhe uljen e normave të interesit, ndikimin pozitiv të monedhës së përbashkët mbi nivelin e investimeve si dhe efektin mbi zhvillimin e tregëtisë. Paralelisht me potencimin e karakteristikave të cilat mundësojnë një integrim të sukseshëm monetarë bëhet prezantim i rezultateve të fituara duke përdorur metoda dhe metodologji bashkëkohore. Një rëndësi e veçantë i kushtohet këndvështrimit të teorisë së zonave monetare optimale e cila kryesisht shtjellon sjelljen e disa indikatorëve makroekonomik, të cilët do të mundësojnë realizimin e një bilanci të brendshëm që nënkupton pikën optimale në mes inflacionit dhe papunësisë

- dhebilancit të jashtëm që nënkupton mbajtjen e zërave në bilancin e pagesës në një nivel të qëndrueshëm dhe stabil. Për çdo indikatorë kandidati paraqet një elaborim të përshtatshëm, i cili rezulton nga përdorimi i një literaturerelevante dhe në të njëjtën kohë zbaton hulumtimet e veta shkencore. Për secilën temë të trajtuar në punim, kandidati realizon një elaborim të pasur duke paraqitur shembuj të përshtatshëm dhe rezultate të hulumtimeve, si dhe janë dhënë propozime, të cilat mund të përdoren për të tejkaluar barrierat ekzistuese në Maqedoni, me qëllim që të krijohet mundësia e një inkuadrimit të mundshëm të Maqedonisë në një formë të caktuar të integritit ekonomik dhe monetarë.
- V. Kandidati nëpërmjet modeleve të përdorur, me sukses artikulon indikatorët dhe faktorët të cilët duhet të konsiderohen me qëllim të një implementimi të një strategjie të suksesshme për inkuadrimit në një zonë monetare. Një relevancë të posatshme i kushtohet kornizës së indikatorëve të prezantuar në punimet e Frankel dhe Rose, në kontekstin e tregtisë, gjegjësisht, lidhjeve tregtare mes shteteve, por edhe të Petroulas, i cili përqendrohet në analizën e rritjes së investimeve në mes shteteve të cilat janë anëtarë të një zone monetare.
- VI. Vëmendje të posatshme në këtë punim i është dhënë sinkronizimit të ciklit të biznesit dhe faktorëve që ndikojnë më së shumti sipas optikës së teorisë së zonave monetare optimale për anëtarësim në zona monetare. Kandidati potencon se tregëtia ka një rol të rëndësishëm në botën e globalizuar dhe se duhet të përlloragitet ndikimi i saj në të gjitha sferat e ekonomisë. Sipas kandidatit edhe pse niveli i zhvillimit ekonomik të deritanishëm të R. së Maqedonisë nuk është në një nivel të duhur, duhet patur konsideratë se, anëtarësimi në një union monetarë është një proces dinamik dhe në zhvillim e sipër, kështu që plotësimi i kriterëve realizohet në etapa të ndryshme.
- VII. Punimi, përveç qarqeve akademike, mund të gjejë përdorim edhe në përgatitjen e strategjive të ndryshme qeveritare, për të mundësuar një zhvillim ekonomik stabil dhe të qëndrueshëm të R. së Maqedonisë.

Komisioni vlerëson se kandidati i posedon kualitetet e nevojshme për të realizuar studime kërkimore-shkencore në fushën e shkencave ekonomike, ndërsa ky punim paraqet shembullin se si duhet të jetë qasja e kandidatëve gjatë përpunimit të një punimi të doktoraturës.

Për këtë qëllim, duke u bazuar në karakteristikat e paraqitura në punimin e doktoraturës dhe kualitetet e kandidatit, komisioni me kënaqësi i propozon Këshillit mësimorë shkencorë të fakultetit ekonomik, të Universitetit të Tetovës që :

- së pari, të miratoj Raportin punimit të doktoraturës me temë, „*Sfidat me të cilat duhet të ballafaqohet Banka popullore e republikës së Maqedonisë për integrim në sistemin monetarë evropian dhe eurozonë*“ të dorëzuar nga kandidati Gazmend Dehari;
- së dyti, të lejojë mbrojtje të punimit të doktoraturës.

Tetovë, 13.05.2020

Antarë të komisionit:

1. Prof.Dr. Seadin Xhaferi _____
2. Prof.Dr. Alifetah Selimi _____
3. Prof.Dr. Ibish Mazreku _____
4. Prof.Dr. Petrit Pollozhani _____
5. Prof.Dr. Etem Iseni _____